



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

**[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)**

**[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)**

**Nr.198**

**dhjetor**

**2008**

## P Ë R M B A J T J A

|                                         | Faqe                                                                                                                                                                                                                                                                       |
|-----------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Dekret nr.5987<br>datë 29.12.2008       | Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare ..... 10785                                                                                                                                                                                                                        |
| Dekret nr.5989<br>datë 30.12.2008       | Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare ..... 10786                                                                                                                                                                                                                        |
| Vendim i KM<br>nr.1631, datë 17.12.2008 | Për shpalljen “Park kombëtar” të ekosistemit natyror Bredhi i Hotovës-Dangëlli me sipërfaqe të zgjeruar ..... 10786                                                                                                                                                        |
| Vendim i KM<br>nr.1633, datë 17.12.2008 | Për disa ndryshime në vendimin nr.279, datë 5.6.1995 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e sasisë së ujit për furnizimin me ujë të qytetit të Tiranës dhe për ujitjen e tokave bujqësore” ..... 10790                                                              |
| Vendim i KM<br>nr.1634, datë 17.12.2008 | Për përcaktimin e procedurave dhe të mënyrës së mbështetjes financiare, për ruajtjen e rezervës gjenetike të racës autoktone të buajve ..... 10790                                                                                                                         |
| Vendim i KM<br>nr.1635, datë 17.12.2008 | Për miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Kuvajtit, për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, për tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin ..... 10791 |
| Vendim i KM<br>nr.1636, datë 17.12.2008 | Për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë, në universitetin “Ismael Qemali”, Vlorë, si dhe për miratimin e kuotave të pranimit e të tarifës së shkollimit në këto programe në vitin akademik 2008-2009 ..... 10792                                            |

|                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                            |       |
|-----------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|
| Vendim i KM<br>nr.1637, datë 17.12.2008 | Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore .....                                                                                                                   | 10783 |
| Vendim i KM<br>nr.1638, datë 17.12.2008 | Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe për procedurën e shitjes .....                                                                                                                                                                      | 10795 |
| Vendim i KM<br>nr.1641, datë 17.12.2008 | Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Voskop, të qarkut të Korçës .....                                                                                                              | 10802 |
| Vendim i KM<br>nr.1642, datë 17.12.2008 | Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Përrenjas, të qarkut të Elbasanit .....                                                                                                       | 10803 |
| Vendim i KM<br>nr.1643, datë 17.12.2008 | Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Vlorë, të qarkut të Vlorës .....                                                                                                                  | 10805 |
| Vendim i ERE<br>nr.107, datë 9.9.2008   | Për disa ndryshime në deklaratën rregullatore të miratuar me vendimin nr.94, datë 14.8.2008 “Për disa ndryshime në vendimin nr.87, datë 6.8.2008 “Për miratimin e deklaratës rregullatore në kuadër të zbatimit të metodologjive të llogaritjes së tarifave të energjisë elektrike”” ..... | 10806 |
| Vendim i ERE<br>nr.132, datë 9.12.2008  | Për kualifikimin e impiantit prodhues (parku eolik Kryevidh, Kavajë) të shoqërisë “Union Eolica Albania” sh.p.k., si burim i rinovueshëm energjie .....                                                                                                                                    | 10811 |
| Vendim i ERE<br>nr.133, datë 9.12.2008  | Për revokimin e vendimit nr.46, datë 10.8.2007 “Për përcaktimin e vlerës së gjobave dhe llogaritjes së dëmit që do të aplikohen ndaj klientëve me kundërvajtje në përdorimin e energjisë elektrike”, të ndryshuar .....                                                                    | 10811 |
| Vendim i ERE<br>nr.134, datë 11.12.2008 | Për miratimin e rregullave dhe procedurave të shitjes së energjisë elektrike te furnizuesit vendas e të huaj .....                                                                                                                                                                         | 10812 |

**DEKRET**  
**Nr.5987, datë 29.12.2008**

**PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

U lejohej lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- |                                           |                                    |
|-------------------------------------------|------------------------------------|
| 1. Alketa Kristo Gjore (Gjika)            | 23. Irin Pal Topalli               |
| 2. Ksantja Eduart (Eduard) Gjore          | 24. Albert Dervish Doku            |
| 3. Zoica Kristo Kokoshari                 | 25. Dhurata Bastri Deda (Mullaj)   |
| 4. Rufan Isa Kariçi                       | 26. Fejzi Rustem Fejziaj           |
| 5. Kin Ndoc Gjonpali                      | 27. Diana Gani Fejziaj (Demi)      |
| 6. Xhyhere Abdyl Stutzenberger (Pellazgu) | 28. Anila Dilaver Manjani          |
| 7. Edmond Spiridhon Kërëku                | 29. Adriano Kujtim Zanin (Kamberi) |
| 8. Sefer Refik Asanlli                    | 30. Elona Kasëm Shaw (Plaka)       |
| 9. Jolanda Besim Asanlli (Shahini)        | 31. Ada Fisnik Kadiu               |
| 10. Joli Sefer Asanlli                    | 32. Dorian Dhimitër Dai            |
| 11. Sefjola Sefer Asanlli                 | 33. Vasian Piro Cepa               |
| 12. Rolando Gjergj Nika                   | 34. Afizjana Orhan Koçi            |
| 13. Sazan Lutfi Skuka                     | 35. Manuela Ilmi Osmani            |
| 14. Aurora Sali Shtara (Rustemi)          | 36. Albana Syrja Caraj             |
| 15. Iris Fatmir Shtara                    | 37. Tushe Latif Arbana             |
| 16. Tobias-Mario Fatmir Shtara            | 38. Altin Riza Lataj               |
| 17. Oltjon Nuri Mehmetaj                  | 39. Henris Hismet Morina           |
| 18. Besa Skënder Mehmetaj (Haveri)        | 40. Ilda Gjon Luzi (Frroku)        |
| 19. Lodxhana Pali Katro                   | 41. Ergys Agim Shehapi             |
| 20. Zhaneto Françesk Ndoja                | 42. Ibrahim Xhevat Kotili          |
| 21. Suzana Halil Muka                     | 43. Gleni (Glen) Arben Schieder    |
| 22. Hatlije Nazmi Honnerlage (Bilbili)    |                                    |

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bamir Topi**

**DEKRET**  
**Nr.5989, datë 30.12.2008**

**PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- |                                        |                                    |
|----------------------------------------|------------------------------------|
| 1. Ardian Dashamir Willoweit (Shtiza)  | 12. Endrit Can Mulaj               |
| 2. Ilira Kujtim Çela                   | 13. Romina Mirosh Jakova           |
| 3. Kozeta Elmas Krulis (Oparaku, Wolf) | 14. Eduart Nazdri Nuhu             |
| 4. Albana Nazmi Alü (Jukni)            | 15. Visar Mustafa Nonaj            |
| 5. Laftjon Hysen Tallalli              | 16. Adivi Muhamet Shabani          |
| 6. Orjeta Hashim Dama                  | 17. Raimonda Hasan Guhl (Haxhiraj) |
| 7. Manjolë Ferit Çakalli               | 18. Gerald Arben Hasani            |
| 8. Leida Muzak Reitor (Karagjozi)      | 19. Rovenë Beqir Pogoni            |
| 9. Rovenë Lutfi Bitzel (Stoli)         | 20. Nadire Kadri Braja             |
| 10. Blerim Subi Hamzaj                 | 21. Ylli Bajram Tatani             |
| 11. Iva Mesut Peterci                  | 22. Arben Gani Mezini              |

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bamir Topi**

**VENDIM**  
**Nr.1631, datë 17.12.2008**

**PËR SHPALLJEN “PARK KOMBËTAR” TË EKOSISTEMIT NATYROR BREDHI I**  
**HOTOVËS-DANGËLLI ME SIPËRFAQE TË ZGJERUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 1, shkronja “b”, 6 e 13, të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpalljen “Park kombëtar” të ekosistemit natyror Bredhi i Hotovës-Dangëlli, me sipërfaqe të zgjeruar, sipas përcaktimeve në hartën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kufijtë “Parku kombëtar”, janë si më poshtë vijon:

a) Veri:

Kuota 1 291,3 m (Maja e Qarrishtës), me koordinata 4 439 461 V dhe 4 469 277 L, vijon përgjatë kurrizit dhe ndjek rrugën vendore, në krah të fshatit Sevrani i Madh, me kuotën 758 m, kalon pranë burimit Gurra e Kafshit, ndjek rrugën vendore dhe kurrizin ujëndarës, me kuotën 1 246,8 m (Maja Sheshi i Mukalisë), vijon me rrugën dhe kuotën 1 254 m, ndjek rrugën dhe zbret kurrizin në drejtim të Përroit të Kreshovës, pasi ndërpret përroin i ngjitet kurrizit, kalon në digën e rezervuarit,

vijon në drejtim të kuotave 1 571 m, 1 232 m, 1 074 m, 835 m, 845 m, ndërpret Përroin e Miçanit, kuota 1 078 m, ndjek rrugën vendore dhe kuotat 1 404 m, 1 503 m, 1 588 m, 1 585 m, 1 827,6 m, 1 663,2 (Maja e Qelqit), ndjek rrugën vendore dhe kuotat 1492 m deri te Qafa e Dëllinjës (1 356 m), me koordinatat 4 455 559 V dhe 4 471 253 L.

b) Lindje:

Kuota 1 356 m (Qafa e Dëllinjës), me koordinatat 4 455 559 V dhe 4 471 253 L, ndjek rrugën vendore dhe kuotat 1 396 m, 1 345,5 m, 1 343 m, 1 431 m, zbret kurrizin në drejtim të kuotës 1 286 m (Maja e Golemasit), ndjek kurrizin Faqja e Gremës, kuotat 1 003 m, 913 m, në pikën e takimit të përroit të Selenicës me përroin e Zavalanit, kuotat 1 061 m, 882 m (maja e Praspqopit), kuota 778 m, kalon te pika e takimit të përroit të Zavalanit me përroin Guri Pelpel, kuota 881 m, ndjek rrugën vendore deri te pika e takimit të përroit Burimi i Krimbur me Përroin e Virit, më pas vijon përgjatë lumit të Anit, kuota 575 m, me lumin e Gostivishtit, me kuotat 479 m, 433 m deri te pika e takimit të lumit të Gostivishtit me lumin e Lengaricës, vijon përgjatë lumit të Lengaricës, në drejtim të kundërt të rrjedhjes, deri te pika e takimit me përroin e Gradishtës, ngjitet kurrizit, kuota 1 110 m, ndjek rrugën vendore, kuota 1 106 m, vijon përgjatë kurrizit Faqja e Lajthizës, në kuotat 1 357 m, 1 382 m, 1 321,5 m, 1 336 m, 1 441 m, 1 477 m, 1 553,4 m (Maja e Postenanit), 1 507 m, 1 523 m, 1 481,9 m, Qafa e Postenanit, 1 488 m, 1 472,7 m, 1 371 m, zbret kurrizin Gryka e Pagmentit deri te pika e takimit të lumit të Çarshovës me përroin e Postenanit, me koordinata 4 463 360 V dhe 4 447 984 L.

c) Jug:

Pika e ndërprerjes së lumit të Çarshovës me përroin e Postenanit, me koordinata 4 463 360 V dhe 4 447 984 L, ndjek rrjedhjen e lumit të Çarshovës në drejtim të lumit Vjosë deri te ura e Çarshovës, me koordinata 4 460 893 V dhe 4 442 781 L.

ç) Perëndim:

Ura e Çarshovës, me koordinata 4 460 893 V dhe 4 442 781 L, ndjek krahun e djathtë të rrugës automobilistike Çarshovë-Përmet, deri te kryqëzimi i rrugës për në fshatin Benjë, kuota 292 m, më pas ngjitet kurrizit të pyllit të Pomecit, kuota 451,1 m (Maja e Malit të Bardhë), ndjek rrugën vendore dhe kuotat 471 m, 558 m, përsëri me rrugën vendore dhe kurrizin Bregu i Madh, Maja e Qytezës, kurrizin mbi fshatin Qilarisht e Vogël, kuotat 636 m, 771 m, 1 028 m, 1 128 m (Hija e Plepit), zbret kurrizin dhe kalon në Qafën e Ajdinit, ndjek rrugën vendore dhe kuotat 928,7 m, 928 m (Guri i Thanëve), zbret kurrizin dhe ndjek rrugën për këmbësorë, kuotat 404.0 m, 451.0 m (Maja e Sukës), ndërpret përroin e Muzhdinës, vijon në krahun e majtë të rrjedhës së kanalit ujitës, kuota 276.0 m (Maja Guri i Kosinës), ngjitet kurrizit në krah të fshatit Kosinjë, kuota 296.0 m, 342.0 m, ndjek rrugën për këmbësorë mbi Kosinë, ura e përroit të Hotovës, kuota 231 m, ndërpret lumin e Lumnicës dhe përroin e Kalenjave, ngjitet kurrizit në kuotat 292 m e 332 m, ndjek rrugën vendore për në fshatin Pacomit (Kalenjë), vijon me rrugën në drejtim të kuotës 988,7 m (Maja e Kokoresit), përsëri me rrugën dhe kuotat 1 025,6 m (Maja e Seniçanit), 1 035 m, 1 038 m, 1 264 m, kalon në kufi të pyllit të Hijës së Sharrës dhe kuota 1 291, 3 m (Maja e Qarrishtës), me koordinata 4 439 461 V dhe 4 469 277 L.

3. “Parku Kombëtar” Bredhi i Hotovës-Dangëlli ka një sipërfaqe të përgjithshme 34 361.05 (tridhjetë e katër mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një presje zero pesë) ha, ku pjesën kryesore të territorit e zënë sipërfaqet pyjore, të ndjekura nga sipërfaqet kullosore, bujqësore, joproduuese, shkëmbore dhe sipërfaqe troje, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. “Parku kombëtar” Bredhi i Hotovës-Dangëlli ndahet në katër nënzona ruajtjeje e administrimi, si më poshtë vijon:

a) Zona qendror, me sipërfaqe 2 888.69 ha (e shënuar në hartë me “ZQ”), përfshin habitatet kryesore natyrore të Bredhit të Hotovës. Ajo përcaktohet si zonë me vlera të larta, për natyrën dhe biodiversitetin dhe në të zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes, që siguron një territor të pashqetësuar.

b) Zona e përdorimit të qëndrueshëm, me sipërfaqe 18 922.50 ha (e shënuar në hartë me “ZPQ”). Në këtë zonë përfshihen habitate, pyjore e kullosore, pothuajse përreth zonës qendrore, për të cilën ajo shërben si zonë buferike. Në këtë zonë lejohen veprimtaritë ekonomike sezonale (si kullotja, grumbullimi i bimëve mjekësore, prodhimeve të dytë të pyllit), të cilat nuk cenojnë integritetin ekologjik të ekosistemit dhe ushtrohen vetëm me leje mjedisi. Në zonën e përdorimit të qëndrueshëm zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes.

c) Zona rekreative, me sipërfaqe 80.28 ha (e shënuar në hartë me “ZR”), përbën zonën me mundësi rekreative, në natyrë të hapur, në përputhje me funksionet e zonës së mbrojtur, vlerat

ekologjike, të peizazhit dhe vlerat turistike e kulturore. Në këtë zonë përfshihen pjesët pyjore, livadhet dhe toka bujqësore në masivin pyjor të Bredhit të Hotovës dhe banjat termale. Në zonën rekreative zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes.

ç) Zona e përdorimit tradicional, me sipërfaqe 12 469.58 ha (e shënuar në hartë me “ZPT”), mundëson vazhdimin e veprimtarive tradicionale dhe ekonomike, dhe në këtë zonë mund të ushtrohen veprimtari të reja, vetëm pasi të pajisen me leje mjedisi, dhe, për rastet e trashëgimisë kulturore, me leje nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe shërbimi arkeologjik. Në këtë zonë përfshihen territoret bujqësore, ujore e disa toka, me bimësi pyjore, ato rreth qendrave të banuara, kryesisht të përdorura nga banorët. Në zonën e përdorimit tradicional zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes.

5. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe ministrinë e tjera të linjës, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, me institucionet kërkimore-shkencore, me përfaqësuesit e biznesit dhe të pronarëve privatë, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të hartojnë planin e menaxhimit të “Parkut kombëtar”.

6. Administrata ekzistuese e zonës së mbrojtur dhe e sektorit pyjor të qendrës (DSHP Përmet) kryejnë funksionet e administratës së “Parkut kombëtar” Bredhi i Hotovës-Dangëlli.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe organet përkatëse të qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

Sasia e sipërfaqeve, sipas përbërjes

Tabela

| Nr. | Përdorimi i territorit                                                                                   | Sipërfaqja në ha |
|-----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|
| 1.  | Sipërfaqe pyjore, pyje të përzier (bredh, ah, pishë, dushk), shkurre, ripyllëzime, tokë me bimësi pyjore | 24 612.02        |
| 2.  | Sipërfaqe kullosore e livadhe                                                                            | 714.14           |
| 3.  | Sipërfaqe bujqësore (arë, pemëtores, vreshta)                                                            | 5 292.83         |
| 4.  | Sipërfaqe ujore (lumenj, përrenj, rezervuarë)                                                            | 25.48            |
| 5.  | Sipërfaqe joproduhuese (shkëmbore, e zhveshur)                                                           | 3 307.84         |
| 6.  | Sipërfaqe urbane dhe troje të përziara me tokë bujqësore dhe pyjore                                      | 408.74           |
|     | Sipërfaqe e përgjithshme                                                                                 | 34 361.05        |



**VENDIM**  
**Nr.1633, datë 17.12.2008**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.279, DATË 5.6.1995 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E SASISË SË UJIT PËR FUNIZIMIN ME UJË TË**  
**QYTETIT TË TIRANËS DHE PËR UJITJEN E TOKAVE BUJQËSORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shkronjat “a” e “b” të paragrafit të parë të vendimit nr.279, datë 5.6.1995 të Këshillit të Ministrave, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“a) Për nevoja të furnizimit me ujë nga ujësjellës-kanalizime, sh.a., Tiranë për qytetin e Tiranës e të rrethinave pranë tij, të përdoret sasia e ujit prej 82 (tetëdhjetë e dy) milionë m<sup>3</sup> ujë në vit.  
b) Për ujitjen e tokave bujqësore të përdoret sasia e ujit 5 (pesë) milionë m<sup>3</sup> ujë në vit.”.

2. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.1634, datë 17.12.2008**

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE TË MËNYRËS SË MBËSHTETJES**  
**FINANCIARE, PËR RUAJTJEN E REZERVËS GJENETIKE TË RACËS AUTOKTONE TË**  
**BUAJVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 3 e 4 të nenit 58 të ligjit nr.9426, datë 6.10.2005 “Për mbarështimin e blegtorisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Mbështetjen financiare, vjetore të fermerëve, për ruajtjen e rezervës gjenetike të racës autoktone të buajve, në Shqipëri, për çdo kre, sipas tabelës së mëposhtme:

| Numërtimi | Emërtimi          | Për ruajtje | Për pjellje | Për remont |
|-----------|-------------------|-------------|-------------|------------|
| a)        | Për buallicat (F) | 10 000 lekë | 10 000 lekë | -          |
| b)        | Për buajt (M)     | 20 000 lekë | 2 000 lekë  | -          |
| c)        | Për remontin      | -           | -           | 5000 lekë  |

2. Ngritjen, pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të komisionit të vlerësimit të mbarështimit dhe ruajtjes së rezervës gjenetike të buajve, veprimtaria e të cilit rregullohet me akt nënligjor të Ministrisë të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

3. Drejtoritë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, në bazë të aktit të vlerësimit, të lëshuar nga komisioni i vlerësimit, t’i paguajnë fermerët, që mbarështojnë buajt, sipas këtyre procedurave:

a) Pagesa për ruajtjen e buallicës të jepet në fund të 6-mujorit të parë të vitit kalendarik,

pavarësisht nëse ajo ka pjellë ose jo.

b) Pagesa për ruajtjen e buallit të jepet në fund të 6-mujorit të parë të vitit kalendarik, pavarësisht numrit të ndërtimeve barrsë, të kryera prej tij në tufën e buallicave, në zonën ku ai “lejohet” të veprojë nga shërbimi zooveteriner i drejtorisë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, në komunën, ku banon fermeri.

c) Pagesa për pjelljen e buallicës të jepet pas 1(një) muaji nga data e lindjes, vetëm pasi të jetë verifikuar, me aktlindje, dhe kitorri të jetë i matrikulluar nga tekniku i ndërzimit dhe shërbimi zooveteriner i drejtorisë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, në komunën, ku banon fermeri.

ç) Pagesa për pjelljen, në rastin e buallit, t’i referohet numrit të buallicave të fekunduara prej tij, të cilat kanë pjellë, në zonën ku ai “lejohet” të veprojë nga shërbimi zooveteriner i drejtorisë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, në komunën, ku banon fermeri.

d) Pagesa për remontin të jepet vetëm për kitorrat e moshës 6-18 muaj, për të dyja seksat.

dh) Pagesa përfitohet vetëm në rastet kur fermeri paraqet dokumentet e mëposhtme:

i) kartelën;

ii) certifikatën veterinare;

iii) pasaportën e kafshës.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

5. Vendimi nr.219, datë 16.5.2002 i Këshillit të Ministrave “Për mbrojtjen e racës autoktone të buajve nga zhdukja”, i ndryshuar, shfuqizohet.

6. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Sali Berisha**

#### **VENDIM**

**Nr.1635, datë 17.12.2008**

#### **PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË KUVAJTIT, PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL, PËR TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE KAPITALIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

#### **VENDOSI:**

Miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Kuvajtit, për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, për tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

**Sali Berisha**

#### **VENDIM**

**Nr.1636, datë 17.12.2008**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË, NË  
UNIVERSITERTIN “ISMAIL QEMALI”, VLORË, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE  
TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME NË VITIN  
AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, pranë Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, në Fakultetin e Shkencave Teknike, të programeve të studimit të ciklit të dytë, si më poshtë vijon:

- i) “Inxhinieri navale”, në përfundim të të cilit lëshohet diploma e nivelit të dytë, DND;
- ii) “Matematikë”, në përfundim të të cilit lëshohet diploma e nivelit të dytë, DND.

2. Programet e studimeve të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe zgjatja normale e tyre është dy vite.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

4. Kuota e pranimeve në programet e mësipërme të ciklit të dytë në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, për vitin akademik 2008-2009, të jetë, si më poshtë vijon:

- i) Inxhinieri navale 25;
- ii) Matematikë 50.

5. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë shpërndan kuotat e vëna në dispozicion të tij, në masën jo më pak se 30 për qind, për studentët, që kanë përfunduar, të paktën, ciklin e parë të studimeve në institucionet e tjera të arsimit të lartë, dhe jo më shumë se 70 për qind, për ata, që i kanë përfunduar këto studime pranë tij. Në rastet kur nuk ka kandidatë nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, që plotësojnë kriteret, atëherë Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, ka të drejtë ta plotësojë kuotën e vënë në dispozicion me studentët, që janë diplomuar në të.

Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve, të përcaktuara nga njësitë kryesore të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, bëhen publike paraprakisht.

6. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që do të regjistrohen me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2008, do të jetë sipas pikës 6.b).I, të vendimit nr.1337, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i dytë i studimeve dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, si dhe tarifat e shkollimit për programet e studimit, të miratuara për vitin akademik 2008-2009”.

7. Kandidatët, që u përkasin shtresave sociale, si: të verbrit, të shurdhët, invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, studentët me aftësi të kufizuara, fëmijët romë apo fëmijët e policëve, të rënë ose të plagosur për shkak të detyrës, të të ish-të përndjekurve politike, që do të fitojnë të drejtën të ndjekin një program studimi, të ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë, do të paguajnë 50 për qind të tarifës së shkollimit.

8. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

9. Në çdo program studimi, të ciklit të dytë, të studimeve me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, studentët e shkëlqyer, nga cikli i parë dhe nga cikli i dytë, nuk e paguajnë tarifën e shkollimit në vitin akademik pasardhës.

10. Kuotat e pranimeve në programet e studimit të ciklit të dytë, sipas pikës 4, që mbeten të parealizuara, rishpërndahen, sipas programeve të ndryshme të studimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë.

12. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.1637, datë 17.12.2008**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME  
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI AGJENCISË  
KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista përbëhet nga 1 (një) fletë dhe përfundon me numrin rendor 1 (një).

2. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, kryetari i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

## 1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

Institucioni i Pushtetit Qendror: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

bashkia/komuna: Tiranë (Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore)

Fusha e përdorimit të pronës: Studimore, projektuese, shkencore në fushën e veprimtarisë minerare, postminerare, hidrokarbureve dhe hidroenergjetike

| Nr.rend. | A                |             |                 | B                                                                           |                                            |                                                   | C                                                                                                                                                                          |                                                                                          |                                                            |                                                                                                                                                                                                      |
|----------|------------------|-------------|-----------------|-----------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------|---------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|          | Zona<br>kadastr. | Nr.pasurisë | Lloji i pronës  | Emri i pronës, adresa                                                       | Sip.total e<br>pronës<br>(m <sup>2</sup> ) | Nga sip.<br>tot. sa<br>ndërtesë<br>m <sup>2</sup> | Funksioni për të cilin përdoret pronja                                                                                                                                     | Ins/enti me përgjegjësi<br>administrative                                                | Inst/enti<br>përdorues, statusi<br>juridik i<br>përdorimit | Të dhëna të tjera<br>(Shënime të veçanta)                                                                                                                                                            |
| 1        | 2                | 3           | 4               | 5                                                                           | 6                                          | 7                                                 | 8                                                                                                                                                                          | 9                                                                                        | 10                                                         | 11                                                                                                                                                                                                   |
|          | 8260             |             | Truall ndërtesë | Ish-instituti TNPM-Tiranë                                                   | 1796.0                                     | 960.94                                            | Zyra për AKBN me qëllim ushtrimin e veprimtarisë studimore, projektuese, shkencore, në fushën e veprimtarisë minerare, postminerare, hidrokarbureve, hidroenergjetike etj. | Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore | Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.                    | Bashkëlidhur këtij formulari jepet planvendosja e ish-ITNPM-së bashkë me anekset dhe sh.1:500 dhe dimensionet kryesore planimetrike të objekteve. Jepet gjithashtu dhe numri i kateve për çdo objekt |
|          |                  |             |                 | 1. Ndërtesa e ish-ITNPM                                                     | 448.61                                     | 448.61                                            |                                                                                                                                                                            |                                                                                          |                                                            |                                                                                                                                                                                                      |
|          |                  |             |                 | 2. Ndërtesa e laboratorit të pasurimit të mineraleve                        | 246.13                                     | 246.13                                            |                                                                                                                                                                            |                                                                                          |                                                            |                                                                                                                                                                                                      |
|          |                  |             |                 | 3. Ndërtesa e impiantit të pasurimit të mineraleve                          | 205.8                                      | 205.80                                            |                                                                                                                                                                            |                                                                                          |                                                            |                                                                                                                                                                                                      |
|          |                  |             |                 | 4. Ndërtesa e oficinës                                                      | 37.3                                       | 37.3                                              |                                                                                                                                                                            |                                                                                          |                                                            |                                                                                                                                                                                                      |
|          |                  |             |                 | 5. Ndërtesa e garazhit                                                      | 23.1                                       | 23.1                                              |                                                                                                                                                                            |                                                                                          |                                                            |                                                                                                                                                                                                      |
|          |                  |             |                 | 6. Oborri i ITNPM-së (sipërfaqja funksionale).adresa: blloku “Vasil Shanto” | 835.06                                     |                                                   |                                                                                                                                                                            |                                                                                          |                                                            |                                                                                                                                                                                                      |
|          |                  |             |                 | Ruga: Bairam Curri                                                          |                                            |                                                   |                                                                                                                                                                            |                                                                                          |                                                            |                                                                                                                                                                                                      |

**VENDIM**  
**Nr.1638, datë 17.12.2008**

**PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE, QË PRIVATIZOHET APO  
TRANSFORMOHET, DHE PËR PROCEDURËN E SHITJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të aktit normativ nr.4, datë 9.7.2008 “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr.9967, datë 24.7.2008, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

**I. PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT TË PASURISË SHTETËRORE**

1. Këtij vendimi i nënshtrohen të gjitha ndërmarrjet apo objektet e veçuara, mjetet kryesore dhe mjetet e xhiros së ndërmarrjeve, shoqërive tregtare dhe institucioneve, me kapital tërësisht shtetëror, për të cilat është dhënë miratimi i ministrit përgjegjës për ekonominë, për fillimin e procedurave të privatizimit apo transformimit në shoqëri tregtare.

2. Institucionet qendrore dhe organet e njësisë të qeverisjes vendore, për pasuritë e ndërmarrjeve apo institucioneve, që kanë në varësi administrative apo në pronësi, dërgojnë mendimin e tyre për privatizimin e këtyre pasurive në ministrinë përgjegjëse për ekonominë. Ministri përgjegjës për ekonominë nxjerr urdhrin e miratimit për privatizim, pas mendimeve të përmendura më sipër.

3. Komisioni i vlerësimit të pronës shtetërore, në zbatim të këtij vendimi, ngrihet nga ministri përgjegjës për ekonominë.

4. Ky komision kryesohet nga kryetari i degës së shoqërive publike, në prefekturën, ku ndodhet objekti, dhe në përbërje ka:

- ekspertë vlerësues, të licencuar sipas nevojave të procesit të vlerësimit;
- përfaqësuesin e ndërmarrjes apo të institucionit, në administrim të të cilit ndodhet aset.

5. Miratimi për përfshirjen në procesin e privatizimit të pasurisë së luajtshme, si elemente të veçanta, bëhet nga institucioni përkatës i varësisë administrative. Pas nxjerrjes së miratimit të privatizimit, ky institucion ngre komisionin e vlerësimit, për vlerësimin e pasurisë. Ky komision kryesohet nga përfaqësuesi përkatës i strukturës administrative dhe në përbërje ka 3 anëtarë, nga të cilët njëri duhet të jetë ekspert vlerësues i fushës përkatëse.

Shpenzimet për përgatitjen e dokumentacionit të vlerësimit (pagesa e ekspertëve etj.) në rastin e mësipërm, mbulohen nga institucioni ose ndërmarrja, në administrim të të cilit ndodhet pasuria.

6. Ngritja e komisionit të vlerësimit për objektet ndërtimore, të cilat kanë qenë në administrim të një subjekti, që nuk ekziston më, bëhet sipas urdhrin të ministrit përgjegjës për ekonominë.

**II. VLERËSIMI I ELEMENTEVE TË PASURISË SHTETËRORE**

1. Procedurat për vlerësimin e pasurisë shtetërore fillojnë me daljen e urdhrin të ministrit përgjegjës për ekonominë.

2. Vlerësimi i objekteve bëhet nga komisioni i vlerësimit, në përputhje me vlerën reale të tregut, në zbatim të legjislacionit në fuqi, duke përdorur metodat e vlerësimit të tregut. Komisioni i vlerësimit mban përgjegjësi ligjore për vlerësimin e kryer dhe për dokumentet e hartuara dhe të nënshkruara prej tij ( genplane, situacione, aktvlerësime etj.).

3. Me daljen e urdhrin të përfaqësuesit të ministrit përgjegjës për ekonominë, për ngritjen e komisionit të vlerësimit të objektit, që do të privatizohet, ekspertët vlerësues të këtij komisioni, brenda 15 ditëve, përgatisin:

a) genplanin e ndërmarrjes apo të objekteve, që do të privatizohen, ku përcaktohen qartë sipërfaqet nën objekt dhe trualli funksional, në pesë kopje origjinale;

b) përshkrimin e ndërmarrjes dhe/ose të objekteve të saj, sipas genplanit.

4. Komisioni i vlerësimit, menjëherë pas marrjes së dokumentacionit të mësipërm, i drejton prefekturës përkatëse, në territorin e së cilës ndodhet objekti, kërkesën për konfirmimin nga zyra e urbanistikës të genplanit të përgatitur nga komisioni i vlerësimit.

5. Prefektura, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së kërkesës së degës së shoqërive publike

përkatëse, konfirmon genplanin në pesë kopje origjinale, dhe ia përcjell degës së shoqërive publike dokumentacionin, të nënshkruar dhe të vulosur nga ana e saj.

6. Pas marrjes së genplanit, të konfirmuar nga prefektura përkatëse, dega e shoqërive publike i kërkon zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme hartën treguese të objektit, që do të privatizohet. Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës, i dërgon DSHP-së hartën treguese, me të dhënat përkatëse të objektit për privatizim, si dhe vërtetimin hipotekor apo certifikatën e pronësisë, nëse ka.

7. Komisioni i vlerësimit, pas marrjes së dokumentacionit nga prefektura përkatëse, i kërkon Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave konfirmimin nëse trulli, në të cilin ndodhet objekti, ka pronarë, të njohur me vendim të komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave.

8. Ekspertët vlerësues përcaktojnë çmimin e shitjes së trullit të objektit, që do të privatizohet, duke u bazuar në çmimin e përcaktuar në hartën e çmimeve, të hartuar nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

9. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, ia dërgon konfirmimin përkatës komisionit të vlerësimit, bashkë me vendimet përkatëse, nëse ka.

10. Afati i plotësimit të dokumentacionit të vlerësimit për ndërtesat dhe ndërtimet, linjat e prodhimit dhe të shërbimit duhet të jetë jo më shumë se 50 ditë nga data e daljes së urdhrat për ngritjen e komisionit të vlerësimit nga titullari, ndërsa për makineritë, pajisjet, mjetet e transportit etj., afati duhet të jetë jo më shumë se 20 ditë.

11. Dokumentacioni i përgatitur nga komisioni i vlerësimit i dërgohet:

a) Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për objektet ndërtimore dhe linjat e prodhimit ose të shërbimit, me shkresë përcjellëse, të nënshkruar dhe të vulosur nga dega e shoqërive publike përkatëse, ku përcaktohen vlera e objektit, sipërfaqja e përgjithshme, ajo nën objekt e ajo funksionale.

b) Ministrisë së Financave (Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike), për makineritë, pajisjet, mjetet e transportit, inventarin ekonomik, mjetet e xhiros etj., me shkresë përcjellëse, të nënshkruar dhe të vulosur nga dega e shoqërive publike përkatëse, kur asetet do të shiten të veçanta.

12. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me marrjen e dokumentacionit të vlerësimit dhe pasi e gjen atë të rregullt, në zbatim të legjislacionit në fuqi, ia përcjell Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike.

13. Vlerësimi i pasurisë së ndërmarrjeve shtetërore, që transformohen, në zbatim të urdhrat të ministrit përgjegjës për ekonominë, bëhet në përputhje me këtë vendim.

### III. PROCEDURA E SHITJES SË PRONËS SHTETËRORE

1. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, 7 ditë pas datës së marrjes së dokumentacionit të vlerësimit nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, i kërkon Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe zyrave rajonale në qarqe konfirmimin, nëse ka vendime të komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave, për trullin përkatës.

2. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe zyrat rajonale në qarqe, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, ia dërgojnë konfirmimin Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, bashkë me vendimet përkatëse, të shoqëruara edhe me planvendosjen e pronës.

3. Shitja e objektit bëhet, si më poshtë vijon:

a) Për rastet kur konfirmohet se objekti ndodhet në trullin e subjekteve të shpronësuara, shitja bëhet pa ankand dhe subjektet e shpronësuara të trullit, në zbatim të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, kanë të drejtën e parablerjes së objektit me vlerën fillestare.

b) Në rastet kur subjektet e shpronësuara të trullit, pas njoftimit të bërë nga Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike), nuk kanë paraqitur dokumentet e pronësisë, deri në afatin e përcaktuar në njoftim, bëhet një njoftim i dytë, në dy gazeta me qarkullim kombëtar dhe njoftohet pronari, duke i lënë një afat të ri, prej 30 ditësh nga data e njoftimit të parë. Nëse edhe në këtë afat të dytë pronari nuk paraqitet, atëherë kryhet shitja e objektit dhe e trullit me ankand, sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim. Vlera e trullit, e përcaktuar sipas hartës së

vlerës, i shkon drejtpërdrejt pronarit për kompensim.

c) Në rastet kur konfirmohet se objekti, që privatizohet, nuk ndodhet në truallin e subjekteve të shpronësuara, ai i nënshtrohet ankandit, sipas procedurave të këtij vendimi. Kur në datën e zhvillimit të ankandit paraqitet subjekti i shpronësuar i truallit me dokumentacionin ligjor, që vërteton pronësinë e truallit të objektit, atëherë subjekti i shpronësuar gëzon të drejtën e parablerjes, me vlerën fillestare të objektit.

4. Në ankandet për shitjen e pasurive të shoqërive në likuidim e sipër nuk zbatohet e drejta e parablerjes për ish-pronarët e truallit. Ata marrin pjesë në ankand si të gjithë të tjerët. Në rastet e shpalljes fitues, ish-pronarëve u zbritet vlera e truallit, e njohur apo e kthyer, me vendim të komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave, e vlerësuar me çmimet e hartës së vlerës së truallit, miratuar nga Këshilli i Ministrave.

5. Procedurat e publikimit fillojnë pasi të jenë dorëzuar, në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, dokumentet e vlerësimit të objektit.

6. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, e pranon dosjen e objektit, nëse për këtë objekt ka dokumentacion të rregullt, i cili u ka kaluar strukturave përkatëse, të përcaktuara në këtë vendim. Në të kundërt kërkohet plotësimi i dokumentacionit.

7. Vlera e fillimit të ankandit është VAM-i, i përcaktuar sipas kreut II të këtij vendimi, (mjete kryesore + mjete xhiroje + vlera e truallit). Ankandi zhvillohet vetëm për vlerën e mjeteve kryesore + vlerën e truallit dhe vlera e mjeteve të xhiros shtohet sipas inventarit fizik, në çastin e dorëzimit të objektit.

8. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, pasi ka pranuar dokumentet e vlerësimit të objektit, ndërmerr hapat përkatëse për publikimin e tij për privatizim, si më poshtë vijon:

a) Periudha e botimit zgjat 21 ditë nga data e botimit të parë dhe bëhet në çdo botim të Buletinit të Njoftimeve Publike, brenda këtij afati. Dita e parë e botimit është data e përcaktuar në njoftimin që Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, dërgon për botim. Brenda këtij afati, ky njoftim botohet edhe në një gazetë, me qarkullim kombëtar.

b) Botimin e listës së objekteve, që do të privatizohen, dhe shpalljen e kësaj liste në faqen e internetit të Ministrisë së Financave, me të dhënat për çdo objekt.

c) Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, fillimisht, vendos njoftim me afishe në mjediset e saj, për zhvillimin e ankandit të tyre, ndërsa dega e shoqërive publike, në prefekturë, i vendos këto afishe në mjediset e veta dhe në ndërmarrjen, ku ndodhet objekti, që privatizohet, sipas të dhënave (afishe) të dërguara nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike. Degët e shoqërive publike, në prefekturë, dërgojnë zyrtarisht, procesverbalin për vendosjen e afisheve, brenda afatit të botimit në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike.

9. Njoftimi për botim përmban të dhënat e mëposhtme:

- Vendin, datën dhe orën e zhvillimit të ankandit;
- Emërtimin dhe vendndodhjen e objektit, që privatizohet;
- Vlerën fillestare të ankandit;
- Sipërfaqen e përgjithshme dhe atë nën objekt;
- Pronarin e truallit, nëse ka, (emër, mbiemër etj.).

10. Pjesëmarrësit në ankand, pas regjistrimit të kërkesës në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, kanë të drejtë të studiojnë dokumentacionin e vlerësimit, që ndodhet i depozituar në këtë drejtori, si dhe të njihen me gjendjen fizike të objektit.

11. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, harton dhe arkivon një procesverbal, i cili përmban:

- Kopjen e buletinit;
- Kopjen e afishimit në gazetë;
- Datat e botimit të njoftimeve;
- Kopjen e njoftimit me afishe.

12. Pjesëmarrësit në ankand duhet të paraqesin në vendin, datën dhe orën e njoftuar, në komisionin e ankandit këto dokumente:

- a) Kërkesën me shkrim për blerjen e objektit;

b) Garancinë bankare (apo mandatpagesën), që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë, për llogari të Ministrisë së Financave.

13. Subjekti i shpronësuar i truallit, së bashku me kërkesën për blerjen e ndërmarrjes ose të objektit, që shtrihet në truallin ish-pronë të tij, duhet të paraqesë në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesën me shkrim për blerjen e objektit;

b) Garancinë bankare (apo mandatpagesën), që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare, vetëm për objektin, për llogari të Ministrisë së Financave, detyrimisht, brenda afatit të pranimit të kërkesave.

c) Vendimin përkatës të komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, apo çdo dokument tjetër ligjor, të regjistruar në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ku përcaktohet se ai është subjekti i shpronësuar i tokës.

ç) Dëshminë e trashëgimisë, prokurën e posaçme të përfaqësimit etj.

14. Kur sipërfaqja e tokës, pronë e subjektit të shpronësuar, shtrihet në mbi 70% të sipërfaqes së truallit nën objekt, për objektin, që privatizohet, e drejta e parablerjes shtrihet në të gjithë objektin, nëse pjesa tjetër nuk ka pronar. Kjo vlen edhe për rastet kur ka disa bashkëpronarë dhe ndërmjet tyre ka një marrëveshje të dokumentuar.

- Për rastet kur për objektin, që privatizohet, ka disa bashkëpronarë të cilët nuk kanë lidhur ndërmjet tyre një marrëveshje dhe asnjëri nga ish-pronarët nuk plotëson kushtin e përcaktuar në paragrafin e parë të kësaj pike, atëherë objekti i nënshtrohet ankandit, sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim dhe ish-pronarët kompensohen.

15. Në rastet kur objektit i është ulur vlera e fillimit të ankandit, subjekti i shpronësuar, për të ushtruar të drejtën e parablerjes, duhet të bëjë pagesën e plotë, sipas vlerës fillestare dhe jo sipas vlerës së ulur.

16. Kur për objektet e shpallura për shitje, sipas procedurave të këtij vendimi, nuk paraqitet asnjë kërkesë për blerjen e tyre, Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) cakton një VAM tjetër, me të ulët se VAM-i fillestar, për privatizimin e objektit.

17. Ulja e VAM-it të objekteve bëhet sipas këtij kategorizimi:

a) Për ndërmarrjet ose objektet, deri në 30%;

b) Për makineritë, pajisjet, inventarin ekonomik, mjetet e transportit, mjetet e xhiros, deri 50%.

Në këto raste, objekti u nënshtrohet edhe një herë të gjitha procedurave të shitjes, të parashikuara në këtë vendim.

18. Për rastet kur mbetet vetëm një blerës, si në publikimin me vlerë fillestare, ashtu edhe për rastin kur objekti është i publikuar me ulje VAM-i, bëhet një njoftim i ri, në një gazetë kombëtare, për një periudhë 10-ditore, si dhe vendoset një njoftim me afishe pranë mjediseve, ku do të kryhen procedurat e zhvillimit të ankandit. Pas këtij publikimi, Ministria e Financave realizon shitjen e objektit.

19. Procedurat për rastet e parashikuara në pikat 3, 8, 9, 17 e 19 fillojnë me miratimin e drejtorit të Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave. Çdo element shtesë është pjesë e botimit.

20. Për rastet kur nuk është realizuar shitja, veprohet si më poshtë vijon:

a) Objektet ndërtimore, të cilat i kanë kaluar të gjitha fazat e shitjes, kalojnë për fond kompensimi fizik për subjektet e shpronësuara.

b) Makineritë, pajisjet, mjetet e xhiros, inventar ekonomik, të cilat nuk janë shitur, pasi janë zbatuar fazat e shitjes, sipas VAM-it fillestar dhe VAM-it të ulur, kthehen nga Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) në degën e shoqërive publike përkatëse.

21. Komisioni i ankandit ka në përbërje:

- përfaqësuesin e Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave kryetar;

- përfaqësuesin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës anëtar;

- përfaqësuesin e organit që ka në administrim objektin anëtar.

Anëtarët e komisionit të ankandit duhet të pajisen me autorizimin përkatës dhe pjesëmarrja e tyre, në datën dhe orën e caktuar për ankand, është e detyrueshme.

22. Komisioni i ankandit ka këto detyra:

- a) Regjistron dhe vërteton identitetin e pjesëmarrësve në ankand, sipas letërnjoftimit, certifikatës së gjendjes civile ose me prokurë të veçantë të përfaqësimit;
- b) Prezanton anëtarët e komisionit të ankandit;
- c) Deklaron vlerën fillestare të ankandit;
- ç) Deklaron hapin e dhënies të ofertave për vlerën fillestare për pjesëmarrësit në ankand;
- d) Drejton marrjen e ofertave;
- dh) Shpall personin e fundit, që deklaron çmimin më të lartë, si fitues i ankandit;
- e) Siguron që dhënia e ofertave të vazhdojë deri sa të ketë oferta të tjera, përpara shpalljes së fituesit.

23. Komisioni i ankandit harton një procesverbal, i cili duhet të përmbajë:

- a) Regjistrimin e identitetit të pjesëmarrësve në ankand, sipas letërnjoftimit, certifikatës së gjendjes civile ose prokurës së veçantë të përfaqësimit;
- b) Emrat e anëtarëve të komisionit të ankandit;
- c) Deklarimin e vlerës fillestare të ankandit;
- ç) Deklarimin e hapit të dhënies së ofertave për vlerën fillestare për pjesëmarrësit në ankand;
- d) Shpalljen e personit të fundit, i cili deklaron çmimin më të lartë, si fitues i ankandit.

Komisioni i ankandit duhet të sigurojë, që dhënia e ofertave të vazhdojë deri sa të ketë oferta të tjera, përpara shpalljes së fituesit.

Procesverbali i ankandit duhet të nënshkruhet nga anëtarët e komisionit dhe pjesëmarrësit në ankand.

24. Pjesëmarrësve të tjerë në ankand, përveç fituesit, u kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar paraprakisht. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, i konfiskohet 20 % e garancisë bankare, e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

25. Personi, që ka fituar të drejtën e blerjes së objektit, nëpërmjet ankandit, ose të drejtën e parablerjes pajiset nga Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike), me autorizim, për kalim pronësie, ku përcaktohen qartë detyrimet e blerësit.

26. Brenda 30 ditëve nga data e zhvillimit të ankandit, blerësi është i detyruar të bëjë pagesën në letra me vlerë dhe bono privatizimi të pjesës së mbetur të çmimit të arritur në ankand të objektit, ndërsa vlera e truallit do të paguhet vetëm me lekë.

Ish-pronarët e truallit, brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të autorizimit për kalim pronësie, janë të detyruar të bëjnë pagesën e vlerës së mbetur të objektit, me letra me vlerë dhe bono privatizimi.

27. Të ardhurat e realizuara nga shitja ndahen, si më poshtë vijon:

a) Për shitjen e objektit (mjete kryesore e mjete xhiroje etj.):

- i) 5% e vlerës së shitjes i kalon Ministrisë së Financave;
- ii) 30 % e vlerës së shitjes i kalon Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
- iii) 65% e vlerës së shitjes i kalon buxhetit të shtetit.

b) Për shitjen e truallit 100 % e vlerës së shitjes kalon për efekt të fondit të kompensimit financiar, për subjektet e shpronësuara, përveç rasteve, kur është i identifikuar ish-pronari i truallit. Në këto raste do të veprohet sipas shkronjës “b” të pikës 3 të kapitullit III të këtij vendimi.

28. Nëse personi, që ka fituar të drejtën e blerjes së objektit, nuk paguan, brenda 30 ditëve pjesën e mbetur të çmimit të arritur në ankand, ai, si fitues ankandi, humbet të drejtën e blerjes, si dhe të marrjes pjesë në ankandin, që do të zhvillohet për rishitjen e këtij objekti. Pagesa 20%, e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand, nuk i kthehet. Objekti rishpallet për shitje, duke zbatuar procedurat e publikimit nga e para, sipas këtij vendimi.

Nëse ish-pronari i truallit, që ka fituar të drejtën e blerjes së objektit, nuk paguan brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të autorizimit pjesën e mbetur të çmimit, atëherë pagesa 20%, e ngurtësuar për pjesëmarrje në blerje, i konfiskohet. Objekti rishpallet për shitje, duke zbatuar procedurat e publikimit nga e para, sipas këtij vendimi.

29. Pas pagesës së vlerës së plotë të objektit, Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) është e detyruar ta lidhë kontratën e shitjes nga pala shitëse (përfaqësuesi i Ministrisë së Financave, drejtori i ndërmarrjes për dorëzimin e pronës, blerësi privat).

Dorëzimi i objektit bëhet, në mënyrë të detyrueshme, nga përfaqësuesi i Ministrisë së Financave dhe përfaqësuesi i institucionit administrues (sipas komisionit të vlerësimit të ngritur), në

prani të blerësit.

30. Kontratat e nënshkruara nga përfaqësuesi i ish-Agjencisë Kombëtare të Privatizimit dhe i degëve të saj në rrethe, për objektet apo ndërmarrjet e privatizuara në vite, me përfaqësuesin e ndërmarrjes dhe blerësit, por jo sipas mënyrës së kërkuar nga ligji (para noterit), për rastet kur aktualisht nuk ekziston ndërmarrja, bëhen nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, dhe blerësi, kur dokumentacioni, që ndodhet në arkivat e kësaj drejtorie është i rregullt. Kur ekziston ndërmarrja bëhet nga drejtori i ndërmarrjes dhe blerësi, para noterit.

31. Në rastet kur nga ish-Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe degët e saj në rrethe janë kryer të gjitha procedurat ligjore, për privatizimin e objekteve apo të ndërmarrjeve shtetërore, sipas dokumentacionit të plotë, që ndodhet në arkivin e Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike (dosja e vlerësimit, ankandi apo e drejta e parablerjes, autorizimi për kalim pronësie, pagesa e plotë etj.), por që, për arsye të ndryshme, nuk ka qenë e mundur të lidhet kontrata e shitjes dhe kur, aktualisht, nuk ekziston ndërmarrja, që e ka pasur në administrim objektin, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, kryetari i degës së shoqërive publike, në prefekturën përkatëse dhe blerësi nënshkruajnë kontratën e shitjes, sipas legjislacionit në fuqi.

32. Nuk lejohen dhënia me qira dhe kalimi kapital i objekteve, që janë publikuar për shitje.

33. Dokumentacioni i vlerësimit të objekteve ndërtimore, të cilat nuk janë shitur edhe pasi janë zbatuar të gjitha fazat e shitjes, sipas këtij vendimi, përcillet nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për t'u përdorur si fond i kompensimit fizik. Për makineritë, pajisjet, mjetet e xhiros, inventar ekonomik, të cilat nuk janë shitur edhe pasi janë zbatuar të gjitha fazat e shitjes, veprohet sipas vendimit nr.70, datë 11.3.1985 të Këshillit të Ministrave "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave, materiale e monetare" të ndryshuar.

34. Për shitjet e bëra nga Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) njoftohet, me një evidencë statistikore, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në datën 20, të çdo muaji. Një kopje e kontratës së shitjes së çdo objekti ndërtimor i dërgohet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Tregtare).

35. Pasuritë shtetërore të dhëna me kontratë qiraje apo enfiteoze, mbi 500 m<sup>2</sup>, i shiten, në mënyrë të drejtpërdrejtë, kontraktuesit, në rast se vlera e investimit të kryer prej tij është mbi 150 % e vlerës së trullit, si dhe kur subjekti nuk ka detyrime ndaj shtetit. Përcaktimi i vlerës së investimeve bëhet nga ekspertë vlerësues të licencuar dhe ekspertë kontabël të autorizuar, të miratuar nga ministri përgjegjës për ekonominë, i cili urdhëron fillimin e procedurës së mësipërme.

36. Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, i paraqet, për miratim, ministrit përgjegjës për ekonominë, vlerën e investimeve të kryera nga qiramarrësi dhe të vlerësuar nga ekspertët përkatës. Me miratimin e vlerës së investimeve, Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike bën krahasimin e kësaj vlere dhe vlerës së trullit, të përcaktuar sipas çmimit të trullit, të konfirmuar nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, dhe sipërfaqes së trullit në kontratën e qiramarrjes. Nëse vlera e investimeve të kryera është mbi 150% e vlerës së trullit, ministri nxjerr urdhrin për përgatitjen e dokumentacionit të privatizimit.

Për rastet kur ka pronarë toke, vlera e trullit, sipas përcaktimit në dosjen e privatizimit, i kalon pronarit për kompensim.

#### IV. DETYRAT DHE TË DREJTAT PËR ZBATIMIN E KËTIJ VENDIMI

1. Përfaqësuesi i Ministrisë së Financave (Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) dhe drejtori i ndërmarrjes janë të detyruar të përfundojnë dorëzimin, me procesverbal, të objektit, që privatizohet, brenda 35 ditëve nga data e dhënies së autorizimit nga Ministria e Financave blerësit.

2. Për diferencat fizike, të lindura ndërmjet periudhës së vlerësimit dhe dorëzimit të objektit ose ndërmarrjes mbahet, në prani të drejtorit të ndërmarrjes një procesverbal, ku evidentohen diferencat fizike dhe arsyet e krijimit. Procesverbali i dorëzimit nënshkruhet nga përfaqësuesi i Ministrisë së Financave, përfaqësuesi i institucionit, që ka në administrim objektin, dhe fituesi i së drejtës së blerjes së objektit. Ky procesverbal shërben si akt dorëzimi i pasurisë.

3. Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) njofton institucionin përkatës administrues për diferencat e rezultuara, sipas procesverbalit të dorëzimit, duke

kërkuar nxjerrjen e përgjegjësisë, zhdëmtimin e tyre dhe, kur është e nevojshme, ndjekjen penale.

4. Shitja e truallit është pjesë e kontratës së shitjes së ndërmarrjes ose objektit.

5. Për rastet kur ka vështirësi në dorëzimin e objektit, me autorizimin e përfaqësuesit të Ministrisë së Financave (Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike), zgjatet afati 35-ditor i dorëzimit. Për rastet kur për blerjen e objektit janë shpallur fitues bashkëpronarë, me të drejtën e parablerjes apo të ankandit, dhe në çastin e nënshkrimit të kontratës njëri nga bashkëpronarët refuzon nënshkrimin e kontratës së shitjes, atëherë zbatohen dispozitat e përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

6. Procesverbal i nënshkruar dorëzohet në Ministrinë e Financave (Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike). Ministria e Financave i kthen vlerën e munguar blerësit, duke u bazuar në diferencat e përligjura, të evidentuara me procesverbalet përkatëse. Përfaqësuesi i Ministrisë së Financave dhe drejtori i ndërmarrjes, që privatizohet, kanë të drejtë të marrin ekspertë, për dorëzimin e pronës shtetërore, kur ndërmarrja e ka vazhduar veprimtarinë dhe kur vërehen mungesa fizike në njësinë e inventarit. Gjatë procesit të dorëzimit, çdo blerës ka të drejtë të marrë pjesë ose të autorizojë një përfaqësues të tij.

7. Kur blerësi e ka fituar të drejtën e blerjes së pronës shtetërore, nëpërmjet ankandit, dhe kur ka diferenca në dorëzimin e objektit, vlera e kthimit të diferencave është vlera e mungesave fizike, të rezultuara sipas VAM-it, shumëzuar me masën e rritjes së vlerës së ankandit, në krahasim me vlerën fillestare të ankandit, për objektin e shitur. Blerësit i kthehet kjo vlerë me urdhër të Ministrit të Financave.

8. Për kontratat e shitjes, të deklaruara të pavlefshme me vendim gjykatë të formës së prerë, duke kthyer palët në gjendjen e mëparshme, Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) kthen dosjen e vlerësimit të objektit në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për fillimin e rivlerësimit të objektit, në zbatim të kreut I të këtij vendimi, dhe të legjislacionit në fuqi, për privatizimin.

9. Procedurat e privatizimit të objekteve apo ndërmarrjeve, të filluara nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, dhe që ndodhen në fazën e pagesës së 80% të vlerës së mbetur të çmimit të objektit apo të çmimit të ankandit, do të përfundohen, sipas procedurave të këtij vendimi.

10. Në zbatim të këtij vendimi nuk përfshihen procedurat e vlerësimit për dokumentacionin e objekteve, për të cilat komisionet e vlerësimit kanë marrë konfirmimet përkatëse në organet e qeverisjes vendore, si dhe dokumentacionet e vlerësimit, që ndodhen në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe në Ministrinë e Financave, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndërsa për procedurat e shitjes do të zbatohet ky vendim.

11. Për objektet e shërbimit stomatologjik dhe farmaceutik, për të cilat është miratuar nga ministri përgjegjës për ekonominë fillimi i procedurave të privatizimit, punonjësit specialistë, që kanë aktualisht kontratë qiraje për objektin, kanë të drejtën e parablerjes, sipas çmimit të përcaktuar në ankand, nëse këto objekte dhe trualli nën objekt nuk kanë pronarë. Destinacioni i këtyre objekteve nuk duhet të ndryshojë.

12. Ky vendim nuk do të zbatohet për praktikat, që ndodhen në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, në zbatim të vendimeve të mëparshme, të cilat janë në proces dhe ndodhen në fazën, kur ka përfunduar pagesa për vlerën e plotë të shitjes së tyre.

13. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave të hartojnë udhëzimet përkatëse, në zbatim të këtij vendimi.

14. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, prefekti i qarkut, organet e qeverisjes vendore dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

15. Vendimi nr.794, datë 21.11.2007 i Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe për procedurën e shitjes”, të ndryshuar, si dhe udhëzimet e dala në zbatim të tyre, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.1641, datë 17.12.2008**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME  
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË  
KOMUNËS VOSKOP TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Voskop të qarkut të Korçës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 43 (dyzet e tre) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 212 (dyqind e dymbëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Voskop për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

| Komuna Voskop                                    |                                                                                            | Lidhja nr.1          |
|--------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|
| Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës                                                               | Lloji i transferimit |
| 1-3, 206-209                                     | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.             | Në pronësi           |
| 4-10                                             | Prona që përdoren në fushën social kulturore.                                              | Në pronësi           |
| 11                                               | Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor                                | Në pronësi           |
| 12-17,210-212                                    | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.                        | Në pronësi           |
| 18-19,22-24                                      | Infrastrukturë, rrugë vendore                                                              | Në pronësi           |
| 25-32                                            | Sistemi i funizimit me ujë të pijshëm.                                                     | Në pronësi           |
| 41-47                                            | Prona që shërbejnë për shërbimin funeral.                                                  | Në pronësi           |
| 48-55                                            | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.                                    | Në pronësi           |
| 56,58,59,61,63,64,66                             | Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (tokë bujqësore produktive).          | Në përdorim          |
| 57,62,65,70,74,80,84,87                          | Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (kanale të treta, tokë joproduktive). | Në pronësi           |

**VENDIM**  
**Nr.1642, datë 17.12.2008**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME  
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË  
BASHKISË PËRRENJAS TË QARKUT TË ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Përrenjas të qarkut të Elbasanit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 113 (njëqind e trembëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 870 (tetëqind e shtatëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Përrenjas për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

| Bashkia Përrenjas                                |                                                                                              | Lidhja nr.1          |
|--------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|
| Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës                                                                 | Lloji i transferimit |
| 1-3                                              | Prona që përdoren në fushën administrative.                                                  | Në pronësi           |
| 4-7,9-16,346                                     | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.                                      | Në pronësi           |
| 20,21,22,24                                      | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.                          | Në pronësi           |
| 25-27,29-31                                      | Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.                 | Në pronësi           |
| 32-41                                            | Varrezat publike.                                                                            | Në pronësi           |
| 60-213,361-373,377,379-383                       | Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji. | Në përdorim          |
| 317-345,374-376,385-444,825,826,493-495          | Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).                       | Në pronësi           |
| 57-59                                            | Prona që përdoren në fushën e shërbimit social.                                              | Në pronësi           |
| 42-56                                            | Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile.                             | Në pronësi           |
| 534,535,537,538-556,565-824                      | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka    | Në përdorim          |

|                         |                                                                                                                         |            |
|-------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
|                         | produktive).                                                                                                            |            |
| 516-522,536,539,557-564 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe joproduktive). | Në pronësi |
| 384                     | Prona që përdoren për ushtirimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik.                                            | Në pronësi |
| 314-316                 | Prona që përdoren në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.                                                                  | Në pronësi |
| 869                     | Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik (prona shtesë).                                                       | Në pronësi |

**VENDIM**  
**Nr.1643, datë 17.12.2008**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË VLORE TË QARKUT TË VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të bashkisë Vlorë, të qarkut të Vlorës sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Vlorë të qarkut të Vlorës, miratuar me vendimin nr.639, datë 29.9.2007, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Vlorë, të qarkut të Vlorës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

| Bashkia Vlorë                                    |                                                        | Lidhja nr.1          |
|--------------------------------------------------|--------------------------------------------------------|----------------------|
| Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës                           | Lloji i transferimit |
| 1-34                                             | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimor. | Në pronësi           |
| 46,48,50-56,58-61                                | Prona që përdoren për                                  | Në pronësi           |

|                                     |                                                                                                                              |             |
|-------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|                                     | realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.                                                                       |             |
| 44,45                               | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë.                                                      | Në pronësi  |
| 99-103,118,122                      | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shërbimit social.                                                  | Në pronësi  |
| 79,83-87,151-153                    | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës.                                                     | Në pronësi  |
| 116                                 | Varrezat publike.                                                                                                            | Në pronësi  |
| 104-115,117,119-121,123-150,645-823 | Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).                                                       | Në pronësi  |
| 74,154,504,576                      | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.                                               | Në pronësi  |
| 155-471                             | Prona që përdoren në fushën e strehimit e mbrojtjes civile.                                                                  | Në pronësi  |
| 626-628,630                         | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).                       | Në përdorim |
| 629                                 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive). | Në pronësi  |

**VENDIM**  
**Nr.107, datë 9.9.2008**

**PËR DISA NDRYSHIME NË DEKLARATËN RREGULLATORE TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.94, DATË 14.8.2008 “PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.87, DATË 6.8.2008 “PËR MIRATIMIN E DEKLARATËS RREGULLATORE NË KUADËR TË ZBATIMIT TË METODOLOGJIVE TË LLOGARITJES SË TARIFAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE””**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 9.9.2008, në kuadër të ushtrimit të autoritetit për zbatimin e metodologjive të vendosjes së tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave, për disa ndryshime në deklaratën rregullatore,

**VENDOSI:**

1. T’i miratojë ndryshimet në deklaratën rregullatore të miratuar me vendimin nr.94, datë 14.8.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e deklaratës rregullatore në kuadër të zbatimit të metodologjive të llogaritjes së tarifave të energjisë elektrike”.

2. Deklarata rregullatore me ndryshimet përkatëse i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

## DEKLARATË RREGULLATORE

### 1. Qëllimi

Kjo deklaratë rregullatore miratohet me qëllim që të bëjë të mundur llogaritjen e tarifave për veprimtaritë e prodhimit publik, furnizimit publik me shumicë, shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakicë në zbatim të metodologjive të tarifave përkatëse të miratuara nga ERE.

ERE ka vendosur që periudha nga 1 mars 2009 deri më 31 dhjetor 2009 të jetë një periudhë tranzitore, gjatë së cilës nuk do të ketë ndryshim në tarifat ekzistuese të energjisë elektrike, sipas vendimit të ERE-s nr.21, datë 14.2.2008. Kjo do të lejojë investitorin të vlerësojë situatën brenda OSSH-së dhe të përgatisë aplikimin për rishikimin e tarifave të energjisë elektrike jo më vonë se 1 shtator 2009, të cilat do të bëhen efektive më 1 janar 2010.

Periudha e parë rregullatore do të jetë 1 janar 2010 – 31 dhjetor 2010;

Periudha e dytë rregullatore do të jetë 1 janar 2011 – 31 dhjetor 2011;

Periudha e tretë rregullatore do të jetë 1 janar 2012 – 31 dhjetor 2014;

Periudhat rregullatore më pas do të jenë nga 3 – 5 vjet.

Tarifat e energjisë elektrike, që do të jenë efektive nga 1 janari 2010, përveç shpenzimeve dhe fitimit për vitin 2010 që do të përcaktohen sipas metodologjisë së tarifave dhe kësaj deklarate rregullatore, do të kompensojnë për vitin 2009 vetëm diferencën për shpenzimet shtesë që lidhen me importin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes. Ky kompensim do të bëhet për diferencën që rezulton ndërmjet nivelit të miratuar të humbjeve 29% për vitin 2008 dhe nivelit të humbjeve prej 32% të lejuara për vitin 2009.

Me përfundimin e tri periudhave të para rregullatore, ERE do të miratojë një deklaratë rregullatore për periudhat e tjera rregullatore në vijim.

### 2. Për tarifën e kompanisë publike të prodhimit (KPP)

#### 2.1 Përcaktimi i vlerës së RAB-it të KPP-së për vitin 2009.

Në përputhje me metodologjinë e llogaritjes së tarifës për KPP-në, RAB-i i KPP-së për vitin 2009 do të llogaritet si shuma e vlerës kontabël të aseteve fikse, që rezulton nga bilanci i audituar, sipas standardeve IFRS të KPP-së në 31 dhjetor 2007, plus investimet e pritshme nga kompania për vitin 2008, plus investimet e parashikuara nga licencuari për vitin 2009 dhe të pranuar nga ERE, minus amortizimin e akumuluar për vitin 2009, plus kapitalin e punës.

#### 2.2 Përcaktimi i normës së kthimit nga kapitali i vet (RoE) për KPP

Duke qenë se KPP do të mbetet në pronësi të shtetit, ajo do të ketë një profil risku financimi të ulët. Për më tepër qeveria nuk kërkon kthime të larta nga kapitali i vet. Për këtë arsye RoE për KPP-në nuk është një normë kthimi e bazuar në treg, por përcaktohet si një përqindje interesi e bonove të thesarit afatshkurtra të Bankës së Shqipërisë.

#### 2.3 Raporti i synuar i borxhit ndaj kapitalit total për KPP-në

Për qëllim të llogaritjes së tarifës së prodhimit të energjisë elektrike, ky raport pranohet të jetë 60% borxh.

#### 2.4 Kapitali i punës

Kapitali i punës i pranuar nuk do të jetë më tepër se 1/12 e OPEX (Shpenzimeve operative), siç përcaktohet në metodologjinë e llogaritjes së tarifës për KPP-në.

#### 2.5 Niveli vjetor i prodhimit hidro të KPP-së

Mesatarja vjetore e prodhimit hidro për 10 vitet e fundit është 4,579 GWh, ndërsa për 5 vitet e fundit është 4,770 GWh.

Duke marrë në konsideratë faktin që KESH-i përdor nivelin 4,200 GWh prodhim hidro për parashikimin vjetor të prodhimit, është e mundur që prodhimi faktik të jetë rreth 2,500 GWh më i lartë se prodhimi i parashikuar nga KESH-i për 5 vitet e ardhshme, duke siguruar kështu qëndrueshmëri të tarifave në të ardhmen dhe minimizim të riskut hidrologjik.

Për llogaritjen e tarifave që FPSH-ja do të aplikojë për FPP-në dhe që KPP-ja do të aplikojë për OST-në, prodhimi vjetor hidro i KPP-së për periudhat rregullatore të përcaktura në këtë deklaratë do të pranohet 4,200 GWh për prodhimin neto në vit.

### 3. Për tarifën e furnizuesit publik me shumicë (FPSH)

#### 3.1 Norma e fitimit

- Për furnizuesin publik me shumicë do të jetë e barabartë me 0.5% mbi blerjet vjetore të energjisë elektrike.

- Për të ulur risqet e FPSH-së, që burojnë nga prodhimi hidro i KPP-së, do të bëhen axhustimet vjetore të mëposhtme:

i) Tarifa e FPSH-së do të përfshijë edhe kosto financiare neto, që i shkaktohen FPSH-së nga risku i sipërpërmendur;

ii) Axhustime për të mbuluar koston e interesit për të mbajtur një linjë kredie të marrë për vitet e thata hidrike;

iii) Axhustime vjetore do të bëhen për tepricat ose mungesat e të ardhurave për KPP-në, që rrjedhin nga ndryshimet në prodhimin hidro nga prodhimi i planifikuar prej 4 200 GWh/vit të vitit paraardhës.

FPSH-ja do të bëjë një tender vjetor në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” për blerjet me shumicë të energjisë elektrike shtesë mbi prodhimin e parashikuar të KPP-së.

#### 4. Për tarifën e shërbimit të shpërndarjes

##### 4.1 Përcaktimi i vlerës së RAB-it për OSSH-në

Vlera fillestare e RAB-it do të llogaritet si shumë:

i) e vlerës së aseteve joqarkulluese sipas bilancit të OSSH-së për vitin 2007 të audituar sipas IFRS, i publikuar;

ii) e vlerës së investimeve aktuale për vitin 2008, e cila parashikohet të jetë 1,900 milionë lekë.

iii) e vlerës së investimeve të parashikuara që do të kryhen gjatë vitit 2009 në përputhje me planin e investimeve të miratuar nga ERE, bazuar në nenin 24 të ligjit për sektorin e energjisë elektrike;

iv) minus vlerën e amortizimit të akumuluar për vitin 2009;

v) e vlerës së kapitalit të punës, e cila do të jetë e barabartë me 1/12 e OPEX-it të lejuar për periudhën për të cilën aplikohet.

ERE nuk ka përcaktuar vlerën fillestare të RAB-it, por si vlerë fillestare të aseteve joqarkulluese do të përdorë vlerën e aseteve joqarkulluese sipas bilancit të OSSH-së të 31.12.2007, të audituar sipas IFRS-ve, e cila është 16,320 milionë lekë. Nga vlera e RAB-it do të zbriten të gjitha asetet joqarkulluese të financuara nëpërmjet granteve. Vlera e aseteve joqarkulluese, të financuara nëpërmjet granteve për vitin 2008 (sipas aplikimit për çmimet e vitit 2008), është 770 milionë lekë.

Axhustimi i RAB-it për vitet e ardhshme do të bëhet në përputhje me metodologjinë e tarifave të shpërndarjes. Kjo metodë reflekton në mënyrë të drejtë investimet fillestare të bëra nga investitori, të cilat duhet të rikthehen nëpërmjet kthimit mbi RAB-in.

##### 4.2 Llogaritjet e koston mesatare të ponderuar të kapitalit (WACC) për OSSH-në

Për qëllim të llogaritjes së tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, WACC-u, i pranuar nga ERE, do të llogaritet mbi baza vjetore siç është shprehur më poshtë:

RoE para takse për OSSH-në do të jetë 14 % për dy periudhat e para rregullatore dhe më pas

ERE do ta rishikojë vlerën e RoE-së, në përputhje me metodologjinë e tarifave dhe me kushtet aktuale të tregut.

ERE do të përdorë normën mesatare të ponderuar të borxhit vjetor në euro në Shqipëri, të publikuar nga Banka e Shqipërisë, plus 2%, si “tavan” për pranimin e normës së interesit mbi borxhet e reja.

Kosto e borxhit për borxhet e vjetra është kosto aktuale e aplikuar sipas termave të marrëveshjes së nënhuasë midis KESH-it dhe OSSH-së. Borxhi i vjetër i referohet borxheve, që i janë ngarkuar OSSH-së në përputhje me marrëveshjen e nënhuasë së saj me KESH-in.

WACC llogaritet si më poshtë:

$$\text{RoE\%} = Y1\%$$

$$\text{CoOD\%} * \text{OldL-T/Total Debt} = Y2\%$$

$$\text{CoND\%} * \text{NewL-T/Total Debt} = Y3\%$$

$$\text{WACC} = 40\% * Y1\% + 60\% * (Y2\% + Y3\%)$$

Ku:

RoE% = Norma e kthimit mbi kapitalin e vet

CoOD% = Norma mesatare aktuale e interesit të borxheve të vjetra

CoND% = Norma mesatare e interesit të borxheve të reja

OldL-T/Total Debt = Pjesa e borxhit të vjetër afatgjatë në totalin e borxhit

NewL-T/Total Debt = Pjesa e borxhit të ri afatgjatë në totalin e borxhit

4.3 Raporti i synuar i borxhit ndaj totalit të kapitalit për OSSH-në:

Për qëllim të llogaritjes së tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, ky raport pranohet 60%.

#### 4.4 Kapitali i punës

Kapitali i punës i pranuar do të jetë i barabartë me 1/12 e OPEX-it (Shpenzimeve operative), siç përcaktohet në metodologjinë e llogaritjes së tarifës për OSSH-në. Për qëllimin e llogaritjes së kapitalit të punës, OPEX i lejuar përfaqëson kostot operative vjetore të lejuara për realizimin e aktivitetit të licencuar, duke përfshiruar amortizimin dhe shpenzimet financiare. Shpenzimet që lidhen me blerjen e energjisë për mbulimin e humbjeve në shpërndarje janë gjithashtu pjesë e OPEX-it të lejuar.

Niveli fillestar i OPEX-it për vitin 2009 do të jetë ai i miratuar në tarifën e vitit 2008:

- 21,000 milionë lekë për OSSH-në; dhe

- 1,800 milionë lekë për FPP.

Vlerat e dhëna më sipër shërbejnë si referencë lidhur me përcaktimin e OPEX-it. OPEX-i i realizuar gjatë vitit 2009 do të shërbejë si bazë për llogaritjen e tarifave për vitin 2010.

#### 4.5 Objektivat e reduktimit të humbjeve

Për të përcaktuar objektivat e reduktimit të humbjeve përgjatë periudhave rregullatore do të merret në konsideratë niveli i pritshëm i humbjeve për vitin 2008 i barabartë me 32% të energjisë së injektuar në rrjetin e shpërndarjes.

Deri tani nuk ka ndonjë studim specifik për vlerësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes. Për qëllime të llogaritjes së tarifës bazuar në përllogaritjet e KESH-it, ERE pranon për periudhën e tretë rregullatore humbjet e përgjithshme (teknike + joteknike) të barabarta me 15%.

ERE pret përmirësim të shpejtë në nivelin e humbjeve joteknike dhe një përmirësim me të ngadaltë, por të vazhdueshëm në reduktimin e humbjeve teknike. ERE parashikon zvogëlimin e humbjeve totale në shpërndarje sipas një skenari të tillë:

4 % reduktim për periudhën e parë rregullatore;

4 % reduktim për periudhën e dytë rregullatore;

9 % reduktim për periudhën e tretë rregullatore (3\*3%).

Gjatë vitit 2009, OSSH-ja do të kryejë një studim të detajuar në vlerësimin e humbjeve teknike. Në qoftë se skenarin e propozuar nga ERE nuk e konsideron të përshtatshëm, OSSH-ja do t'i propozojë ERE-s një program për reduktimin e humbjeve totale për tri periudhat rregullatore të përmendura më sipër, të ndarë sipas viteve të shoqëruar me planin e investimeve për reduktimin e humbjeve sipas këtij programi, duke respektuar objektivin përfundimtar prej 15% humbje totale në fund të periudhës së tretë rregullatore. Vlera e investimeve për reduktimin e humbjeve, sipas programit të paraqitur nga OSSH-ja, miratohet nga ERE bazuar në nenin 24 të ligjit për sektorin e energjisë elektrike.

ERE do të përdorë çmimin mesatar vjetor të importit të energjisë elektrike të vitit paraardhës të realizuar nga FPSH-ja si “benchmark” për llogaritjen e shpenzimeve të OSSH-së për blerjen e energjisë për mbulimin e humbjeve totale. Çmimi i vlerësuar i FPSH-së do të shumëzohet me humbjet totale të pranuar nga ERE-ja.

Duke iu referuar shpenzimeve të OSSH-së për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të miratuara nga ERE, çdo realizim më i lartë i kostove për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve do të jetë përgjegjësi e OSSH-së, ndërsa çdo realizim më i ulët i këtyre kostove do të jetë në përfitim të OSSH-së.

Çmimi “benchmark” i blerjes së energjisë do të jetë rezultat i prokurimeve mbi baza vjetore të FPSH-së për blerjen e energjisë në tregun konkurrues, për të përmbushur kërkesën e konsumatorëve të brendshëm për energji elektrike, përveç energjisë që ai blen nga burimet e brendshme me kosto të ulët dhe me çmime të rregulluara.

Megjithatë ERE do ta lejojë OSSH-në të firmosë kontrata me afat më të gjatë se një vit, për blerjen e energjisë për mbulimin e humbjeve, duke i dhënë mundësinë OSSH-së për të mbajtur përfitimet e mundshme që rrjedhin nga një çmim i favorshëm i energjisë në treg.

#### 5. Përcaktimi i faktorit X

5.1 Vlera e faktorit X për të tri periudhat rregullatore do të jetë zero.

5.2 ERE do të njohë çdo përfitim që vjen nga reduktimi i shpenzimeve operative (pa përfshirë humbjet) dhe do t'i lihet investitorit deri në fund të periudhës rregullatore përkatëse. Korrektimi i OPEX-it të periudhës pasardhëse, do të jetë pjesë e gjykimit të ERE-s.

#### 6. Për tarifën e furnizuesit publik me pakicë (FPP)

- Tarifa e FPSH-së do të jetë kosto e njohur për FPP-në.

- Norma e fitimit për furnizuesin publik me pakicë do të jetë e barabartë me 1% mbi shpenzimet vjetore për blerjen e energjisë elektrike nga FPSH me çmime të rregulluara. Norma e fitimit të FPP-së bazohet vetëm në koston e energjisë së blerë nga e FPSH-së dhe ajo nuk llogaritet mbi kostot e transmetimit, shpërndarjes apo kostot e ndonjë shërbimi ndihmës, si dhe koston e energjisë elektrike të blerë nga OSSH-ja për të mbuluar humbjet.

- Për tri periudhat e para rregullatore ERE do ta lejojë nivelin e borxhit të keq në masën 4% në vit. Kjo normë do të aplikohet mbi totalin e të ardhurave të faturuara nga FPP, duke përfshirë të gjithë komponentët e tarifave për FPSH, OST dhe OSSH dhe duke përfshirë TVSH.

- Në lidhje me strukturën e tarifave të konsumatorëve familjarë, ERE ka ndërmarrë një studim për të përcaktuar konsumin minimal mujor.

Rezultatet e këtij studimi do të përdoren për të rishikuar nivelin e bllokut të parë për konsumatorët familjarë në tarifën që do të hyjnë në fuqi në 1 janar 2010.

#### 7. Cilësia e shërbimit të furnizimit me energji elektrike

- ERE ka përcaktuar vetëm dy tregues të cilësisë së shërbimit, derisa standardet për cilësinë e shërbimit të përgatiten:

- Ndërprerje të furnizimit me energji elektrike (me shpeshtësi dhe kohëzgjatje) në raste riparimesh dhe remontesh, që do të kryhen nga OSSH-ja. OSSH-ja duhet t'i paraqesë ERE programin e remonteve mbi baza vjetore.

- Saktësi të faturimit 99 %. Saktësia e faturimit është kritike për të reduktuar humbjet dhe për të qenë të drejtë ndaj konsumatorëve. Për më tepër ERE dhe OSSH-ja/FPP-ja, duhet të punojnë së bashku për të vendosur rregulla për shpeshtësinë e leximit të matësve dhe se si do të ndahet konsumi i energjisë elektrike për çdo muaj në rastet kur një matës lexohet më rrallë se një herë në muaj.

Standardet për cilësinë e shërbimit do t'i propozohen ERE-s nga investitori në të ardhmen, në bashkëpunim me të licencuar të tjerë. Standardet do të trajtojnë cilësinë dhe gjithashtu edhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike. ERE parashikon që ky proces të zgjasë rreth 1 vit për FPP dhe OSSH, derisa ata të analizojnë sistemin, të zhvillojnë nivelet e benchmarkut për çdo standard të cilësisë dhe sigurisë, të zhvillojnë objektivat, të zhvillojnë programet për të arritur këto objektiva.

#### 8. Dispozita përfundimtare

Sikurse në të gjitha dokumentet zyrtare të miratuara nga ERE, versioni shqip i këtij dokumenti është versioni zyrtar.

#### 9. Miratimi

Kjo deklaratë rregullatore u amendua nga Bordi i Komisionerëve me vendimin nr.107, datë 9.9.2008.

**VENDIM**  
**Nr.132, datë 9.12.2008**

**PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES (PARKU EOLIK KRYEVIDH, KAVAJË)  
TË SHOQËRISË “UNION EOLICA ALBANIA” SHPK, SI BURIM I RINOVUESHËM  
ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 39 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, neni 9, pikat 1 dhe 2, germa “a”, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 9.12.2008, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Union Eolica Albania” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues (Parku eolik Kryevidh, Kavajë), si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

- me vendimin nr.120, datë 9.10.2008, Bordi i Komisionerëve ka filluar procedurat e shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “Union Eolica Albania” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues (parku eolik Kryevidh, Kavajë), si burim i rinovueshëm energjie;

- dokumentacioni bashkëlidhur aplikimit është në përputhje me kërkesat e neneve 6 dhe 7, pikat 1, 2 dhe 3 të rregullores së procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të kualifikojë impiantin prodhues (Parku eolik Kryevidh, Kavajë) të shoqërisë “Union Eolica Albania” sh.p.k., si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Bujar Nepravishta**

**VENDIM**  
**Nr.133, datë 9.12.2008**

**PËR REVOKIMIN E VENDIMIT NR.46, DATË 10.8.2007 “PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS  
SË GJOBAVE DHE LLOGARITJES SË DËMIT QË DO TË APLIKOHEN NDAJ  
KLIENTËVE ME KUNDËRVAJTJE NË PËRDORIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe neneve 1 dhe 2 të ligjit nr.9997, datë 22.9.2008 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 7 dhe 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.12.2008, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Vendimi nr.46, datë 10.8.2007 “Për përcaktimin e vlerës së gjobave dhe llogaritjes së dëmit, që do të aplikohet ndaj klientëve me kundërvajtje në përdorim të energjisë elektrike”, i ndryshuar, për shkak të ndryshimit të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” sipas ligjit nr.9997, datë 22.9.2008, nuk plotëson më qëllimet e ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të revokojë vendimin nr.46, datë 10.8.2007 “Për përcaktimin e vlerës së gjobave dhe llogaritjes së dëmit, që do të aplikohet ndaj klientëve me kundërvajtje në përdorim të energjisë elektrike”, të ndryshuar.

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OSSH sh.a. dhe KESH sh.a. për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Bujar Nepravishta**

**VENDIM**  
**Nr.134, datë 11.12.2008**

**PËR MIRATIMI E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE, TË SHITJES SË ENERGJISË  
ELEKTRIKE TE FURNIZUESIT VENDAS E TË HUAJ**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa “1”, dhe 9, pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.12.2008, pasi shqyrtoi draftin e rregullave të procedurave të shitjes së energjisë elektrike te furnizuesit vendas e të huaj,

**VENDOSI:**

1. T’i miratojë rregullat e procedurave të shitjes së energjisë elektrike te furnizuesit vendas e të huaj (rregullorja bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Bujar Nepravishta**

**RREGULLAT DHE PROCEDURAT E SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TE  
FURNIZUESIT VENDAS E TË HUAJ**

**Neni 1**  
**Autoriteti**

Këto rregulla hartohen në zbatim të nenit 8, pika 2, germa “1” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”.

**Neni 2**  
**Qëllimi**

Të sigurojë rregulla dhe procedura të thjeshta për operime të shpejta, bazuar në një proces konkurrues dhe transparent për realizimin e shitjes së energjisë elektrike pa cenuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike të klientëve.

### Neni 3 **Përcaktime**

Në këtë rregullore termat e përdorur më poshtë do të kenë kuptimin:

1. ERE:

Do të thotë Enti Rregullator i Energjisë, i cili është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror.

2. KESH sh.a.:

Do të thotë Koorporata Elektroenergjetike Shqiptare, e cila kryen aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike dhe të furnizuesit publik me shumicë.

3. OSSH sh.a.:

Do të thotë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, i cili kryen edhe aktivitetin e furnizuesit publik me pakicë (FPP).

4. Shitje e energjisë elektrike:

Do të thotë kalimi në sasi dhe në kohë i energjisë elektrike nga KESH sh.a. te furnizuesit vendas dhe të huaj kundrejt pagesës dhe sipas procedurave në këtë rregullore.

5. Shitje e energjisë elektrike të tepërt:

Do të thotë shitja e energjisë elektrike pas sigurimit, nga KESH sh.a. të nevojave të OSSH sh.a. FPP.

6. Plani i optimizmit të burimeve hidro është programi i hartuar mbi baza vjetore, mujore, javore dhe ditore, nga KESH sh.a. në bashkëpunim me OST sh.a., që përcakton sasinë e energjisë që do të prodhohet në periudha të përcaktuara kohore, si dhe nivelin maksimal të prurjeve të pritshme dhe të nivelit të rezervuarit të çdo centrali.

7. Prurje të mëdha:

Do të thotë prurje e ujit të lumit, në sasi të tillë, që kërcënojnë arritjen e nivelit kritik në rezervuarin e hidrocentralit dhe imponojnë shkarkimin urgjent të ujit, pa përfitim të energjisë elektrike nga rezervuari, ndonëse hidrocentrali punon me kapacitet maksimal.

8. Shitje e energjisë elektrike në kushtet e prurjeve të mëdha:

Do të thotë shitje e energjisë elektrike nga KESH sh.a., në kushtet e prurjeve të mëdha, kur hidrocentrali nuk punon me ngarkesë të plotë, për të bërë të mundur ngarkimin e tij, me ngarkesën maksimale të lejuar, në mënyrë që të përjashtohet shkarkimi i ujit pa prodhim energjie elektrike.

9. Kandidat:

Do të thotë një person fizik ose juridik i ftuar për të marrë pjesë ose shpreh interes për të kontraktuar me KESH sh.a. për blerje të energjisë elektrike.

10. Ftesa për shitje:

Përfaqëson dokumentin me anë të cilit KESH sh.a. iu drejtohet kandidatëve të ndryshëm e që publikohet detyrimisht në faqen elektronike të KESH sh.a.

11. Urdhri për kryerjen e procedurave të shitjes:

Është akti ekzekutiv i Drejtorit të Përgjithshëm të KESH sh.a. që përcakton të dhëna të karakterit teknik ekonomik, si dhe përcakton komisionin që do të ndjekë zbatimin e urdhrin.

12. Oferta për blerje:

Është tërësia e dokumenteve, të dërguara me postë, fax ose dorazi, me anë të së cilës një kandidat i përgjigjet ftesës për shitje të KESH sh.a.-së.

13. Terma komercialë:

Është tërësia e elementeve që kanë të bëjnë me çmimet e energjisë elektrike dhe tarifat apo pagesat e tjera që shoqërojnë transaksionin e shitjes.

#### Neni 4 **Përgjegjësitë**

Përcaktimi në sasi dhe në kapacitet i energjisë elektrike që do të shitet sipas procedurave të kësaj rregulloreje, si dhe përcaktimi i periudhës kohore dhe programit të livrimit të saj është përgjegjësi e KESH sh.a.-së dhe bazohet në optimizmin e përdorimit të burimeve energjetike sipas planifikimit të kryer nga KESH sh.a.-ja dhe OST sh.a.-ja në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit.

#### Neni 5 **Zbatimi**

Kjo rregullore do të zbatohet për shitjet e energjisë elektrike të kryer vetëm si transaksion financiar fitimprurës për KESH sh.a.-ja në rastet si më poshtë:

- a) Shitjes së energjisë elektrike të tepërt që rezulton nga diferenca e energjisë së prodhuar nga KESH sh.a.-ja dhe energjisë së planifikuar sipas planit të optimizmit të burimeve hidro;
- b) Shitjes së energjisë elektrike nga prurjet e mëdha, e kryer me synimin për të evituar shkarkimin e ujit pa prodhim energjie elektrike.

#### Neni 6 **Parimet për procedurat e shitjes së energjisë elektrike**

1. Shitja e energjisë elektrike sipas nenit 5, do të kryhet në bazë të parimeve të transparencës dhe të efikasitetit ekonomike që lidhet jo vetëm me transaksionin e kryer, por me të gjithë aktivitetin në tërësi të shoqërisë publike KESH sh.a.

2. Sasia e energjisë elektrike që shitet, asnjëherë nuk duhet t'i dëmtojë interesat e klientëve tariforë. Nuk lejohet të bëhet shitje e energjisë elektrike për qëllim përfitimi duke pakësuar furnizimin me energji elektrike të klientëve tariforë.

#### Neni 7 **Marrëveshjet për shitjen e energjisë elektrike**

1. Shitja e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë publike KESH-sh.a.-së dhe shoqërive që ofrojnë blerje të energjisë elektrike, në kuptim të nenit 5, të këtyre rregullave kryhet sipas rastit mbi bazë të:

- a) marrëveshjeve në parim ndërmjet KESH sh.a.-së dhe kompanive që ofrojnë blerje të energjisë elektrike;
- b) marrëveshjeve midis palëve, që rrjedhin nga negociatat korrente të KESH sh.a.-së me shoqëritë vendase ose të huaja që ofrojnë blerje të energjisë elektrike.

2. Dispozitat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, nuk përjashtojnë zbatimin e procedurave sipas nenit 9 të kësaj rregulloreje.

#### Neni 8 **Ftesa për shitje të energjisë elektrike**

Për çdo shitje, në përputhje me nenin 5 të këtyre rregullave, shoqëria publike KESH sh.a. harton ftesën me termat përkatës për shitjen e energjisë elektrike. Oferta përmban:

- Sasinë e energjisë elektrike MWh që ofrohet për t'u shitur;
- Grafikonin ditor të livrimit;
- Kohëzgjatjen e livrimit në ditë/javë;
- Periudhën e plotë kohore të livrimit të energjisë elektrike të përcaktuar në marrëdhëniet kontraktuale (shitjes).

#### Neni 9 **Procedura e shitjes së energjisë elektrike**

1. Në bazë të kërkesës për shitje të energjisë elektrike, që hartohet nga KESH GEN, Drejtori i Përgjithshëm i KESH sh.a. nxjerr urdhrin për kryerjen e procedurave të shitjes së energjisë elektrike. Urdhri do të përmbajë të paktën:

- Sasinë e energjisë elektrike MWh që ofrohet për shitje;
- Grafikun ditor të livrimit;
- Kohëzgjatjen e livrimit në ditë/javë;
- Periudhën përfundimtare të plotë të kontraktimit (shitjes);
- Komisionin e kryerjes së procedurave të shitjes.

2. Komisioni i përgatit ftesën për shitje që u drejtohet në mënyrë të dokumentuar të gjitha shoqërive vendase ose të huaja, që operojnë në tregun rajonal të energjisë elektrike. Ftesa përmban kërkesat e përcaktuara në nenin 8, si dhe termat komerciale të shitjes dhe afatin e dorëzimit të ofertave. Kjo kërkesë publikohet në faqen elektronike të KESH sh.a-së në po të njëjtën ditë që u drejtohet shoqërive të ndryshme nga KESH-sh.a.

3. Brenda afatit të përcaktuar në ftesën për shitje, komisioni do të pranojë ofertat e kandidatëve të ndryshëm dhe do të lejojë pjesëmarrjen e përfaqësuesve të tyre gjatë hapjes së ofertave. Komisioni do të vlerësojë jo më vonë se 24 orë nga pranimi i tyre, ofertat e paraqitura dhe do të zgjedhë ofertën ose ofertat më të leverdisshme.

4. Në kushtet e paraqitjes së vetëm një oferte, Komisioni do të procedojë me pranimin dhe vlerësimin e leverdisshmërisë së saj për KESH sh.a.-në.

5. Në çdo rast komisioni do t'i paraqesë menjëherë për miratim Drejtorit të Përgjithshëm të KESH sh.a.-së një raport përmbledhës të kryerjes së procedurave dhe një analizë të ofertës ose ofertave të përzgjedhura duke argumentuar leverdisshmërinë e tyre.

6. Drejtori i Përgjithshëm i KESH sh.a.-së jo më vonë se 24 orë nga marrja e raportit përmbledhës shpall ofertën fituese.

7. Komisioni do të mbajë procesverbal për çdo veprim procedural të kryer në funksion të procedurës së shitjes dhe ka përgjegjësinë për ruajtjen e kufidencialitetit të të gjitha ofertave të marra nga të interesuarit.

8. Brenda një periudhe jo më shumë se 24 orë, nga marrja e vendimit për shpalljen e ofertës/ofertave fituese, KESH sh.a. do të negociojë për lidhjen e kontratës. Nëse ofertuesi fitues refuzon të lidh kontratën për blerjen e energjisë elektrike, atëherë KESH sh.a. do të procedojë me negociim për lidhjen e një kontrate me ofertuesin e radhës.

9. I gjithë dokumentacioni së bashku me kontratën e lidhur midis KESH sh.a.-së dhe ofertuesit fitues, do të regjistrohet dhe ruhet sipas legjislacionit në fuqi.

#### Neni 10

##### **Deklarata e konfliktit të interesave**

Pas pranimit të ofertave çdo anëtar i komisionit do ta nënshkruajë deklaratën me anë të së cilës shpreh mungesën e konfliktit të interesave të tij me ofertuesit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nëse një nga anëtarët e komisionit është në kushtet e konfliktit të interesave me një nga ofertuesit, atëherë kryetari i komisionit do t'i kërkojë Drejtorit të Përgjithshëm zëvendësimin e tij. Deri në emërimin e anëtarit tjetër, komisioni nuk do të procedojë me vlerësimin e ofertave.

#### Neni 11

##### **Monitorimi i shitjes së energjisë elektrike**

1. Të gjitha operacionet e shitjes së energjisë elektrike do të dokumentohen me saktësi. Asnjë shitje nuk lejohet të kryhet pa dokumentacionin shoqëruar të kërkuar.

2. KESH-sh.a. ka detyrim t'i japë në mënyrë transparente ERE-s të gjithë dokumentacionin e kërkuar prej saj për shitjet e energjisë elektrike në kuadër të autoritetit të ERE-s për të monitoruar të licencuarit.

#### Neni 12

##### **Rishikimi**

Këto rregulla janë objekt rishikimi me vendim të Bordit të Komisionerëve, sipas procedurave

të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s.

Neni 13  
**Sanksione**

Shkelja e këtyre rregullave, kur nuk përbën vepër penale, dënohet nga ERE, në përputhje me nenin 64 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

Neni 14  
**Hyrja në fuqi**

Këto rregulla hyjnë në fuqi menjëherë dhe botohen në Fletoren Zyrtare.

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).**  
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 8.1.2009  
Doli nga shtypi më 10.1.2009

|                    |                  |
|--------------------|------------------|
| Tirazhi: 3300 copë | Formati: 61x86/8 |
|--------------------|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2009

Çmimi 36 lekë